



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:097388

Datë: 01.09.2022

Numri i dokumentit: 03380584

P. nr.193/221

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja Ilirjana Hoti, me zyrtaren ligjore Merita Xharavina, në çështjen penale kundër të akuzuarit E. R. nga fshati . . .R. J. nga Gjakova, për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 lidhur me par. 1 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë, PP/II nr.600/22 të datës 13.05.2022 të pranuar në gjykatë me datën 16.05.2022, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **17.08.2022**, në prani të Prokurorit të shtetit Qazim Xharra si dhe të akuzuarit, me dt. 19.08.2022 morri dhe publikisht shpalli, ndërsa përpiloi me dt. 29.08.2022 këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari **E. R.** nga fshati . . . Komuna e Gjakovës, rr.”. . .” pa nr., data e lindjes . . ., në Gjakovë, i biri i M. dhe i nënës A. e gjinisë T., ka te kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar, shtetas R. Kosovës, i pa martuar, me ID . . .

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse :

-me dt.21.01.2022 rreth orës 22:00 min, në Rr. “. . .” -Gjakovë, patrulla policore gjatë pikës së kontrollit kishte ndal veturën e tipit . . . me targa . . ., me shofer-dëshmitarin F. B. dhe pasagjer të pandehurin E. R. dhe dëshmitarin S. P., të njëjtit pas legjitimitit janë kontrolluar dhe gjatë kontrollës është vërejtur se i pandehuri pa autorizim ka poseduar narkotik, substanca psikotrope ose analoge, në atë mënyrë që ditën kritike në kohën dhe vendin e lartcekur, zyrtarët policor gjatë kontrollit tek i pandehuri E. në gjepin e majtë të xhakëtës së tij është gjetur një mulli (grinder) ndërsa pas kontrollit të detajuar është gjetur sasi e substancës narkotike, ku sipas raportit të ekspertimit të dt.25.02.2022 rezultoi të jetë narkotikë i llojit Marihuanë me peshe neto 0.70 -0.0001 gram.

-me çka ka kryer veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-ës,

Andaj Gjykata në mbështetje të nenit 4, 7, 17 par.1, 38, 39, 40, 43, 69, nenit 269 par.2 lidhur me par. 1 të KPRK dhe nenit 365 të KPPK-së, -së, të akuzuarit i shqipton;

DËNIM ME GJOBË

Dënim me gjobë në shumën prej **300.00 (treqind) euro**, të cilën shumë obligohet që ta paguaj në afat prej 30 ditësh, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma tjera të parapara sipas nenit 43 par.3 të KPRK-së ,atëherë i njëjti do t'iu zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **15 (pesëmbëdhjet) ditësh** ,duke llogaritur për çdo ditë burgu prej **20,- €(njëzetë)euro**.

Detyrohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30.00 €** , në afat prej **15 ditëve** ,pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë në.

Gjykata bazuar në nenin 269 par.3 të KPRK-ës, të akuzuari i **Konfiskohet** substanca narkotike e llojit Marihuanë me peshë 0.70+-0.000 gram, një mulli dhe një grinder, të sekuestruara me datën 21.01.2022 nga stacioni policor ,e që janë objekt i kësaj vepre penale.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II nr.600/22 të datës 13.05.2022, ka akuzuar të akuzuarin E. R. nga fshati . . . Komuna Gjakovë , për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së.

Gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt. 17.03.2022, prokurori i shtetit Qazim Xharra, lexon aktakuzën PP/II nr.600/22 të datës 13.05.2022, me ç 'rast deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës.

Gjykata konstaton se sipas përshkrimit të veprës penale nga ana e Prokurorit të shtetit me aktakuzën PP/II.nr. 600/22 të datës 13.05.2022,vlerësoi se nuk ekzistojnë elementet e veprës penale nga neni 269 par.1 të KPRK-së , me që sipas vlerësimit të gjykatës par.1 i kësaj dispozite nga neni 269 të KPRK-së , është paraparë se : *“kushdo që pa autorizim posedon narkotikë , substanca psikotrope apo analoge , dënohet me gjobë dhe me dënim me burgim prej 1(një) deri në 3 (tre) vjet* ndërsa par.2 i kësaj dispozite nga neni 269 është paraparë se : *Kryesi që kryen veprën nga par.1 i këtij për herë të parë dhe i cili posedon më pak se 3(tre) gram)të substancës narkotike apo substancave narkotike apo substancave psikotrope ose analoge dënohet me gjobë ose me burgim deri në 1(një) vit.*, andaj Gjykata konform nenit 360 par. 2 të KPPK-ës ,ka bërë përmirësimin e kualifikimit të veprës penale ashtu që në vend të par.1 duhet të jetë par. 2 lidhur me 1 të nenit 269 të KPRK-së pasi që sasia e narkotikut të sekuestruar tek i pandehuri E.1 është 0.70+-000 gr , e po ashtu bazuar nga të dhënat nga data bazë e gjykatës lidhur me faktin se a ka qenë i dënuar rezulton se i njëjti nuk ka të kaluar kriminale andaj në rastin konkret janë plotësuar dy kushtet ligjore nga neni 269 par.2 të KPRK-së.

I akuzuari E. R. , duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se: , thekson se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pendohet duke i ditur edhe me parë pasojat dhe favore të pranimin të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë me pranimin e fajësisë në çdo fazë të procedurës jam penduar për veprën e kryer, kërkojë falje nga gjykata për veprimet e mijë, premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet, me qene se nuk jam përdorues i rregullt i narkotikëve, por të njëjtën e përdori kohë pas kohe, andaj i propozoi gjykatës që të merr parash rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë , pendimin e shprehur në gjykatë, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale të natyrës së njëjtë apo të ngjashme, faktin se me parë nuk kam rënë në ndesh me ligjin të me shqiptojë një dënim me të butë, e po që se për këtë vepër penale parashihet dënim me burgim të njëjti të më zëvendësoi me gjobë.

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari Prokurori i shtetit Qazim Xharra deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga këtu i akuzuari E. R., pasi që i njëjti pranimin e

fajësisë e ka bere ne mënyrë vullnetare dhe pa presion duke i kuptuar pasojat dhe favoret e pranimit te fajësisë te sqaruara nga ana e gjykatës, duke marr parasysh se aktakuza ka mbështetje ne provat personale dhe materiale ne bazë te cilave është paraqitur gjendja faktike ne dispozitiv ku edhe përmbushen te gjitha elementet e veprës penale me te cilën ngarkohet i akuzuari, andaj i propozoj gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor konform dispozitave ligjore të dënohet dhe të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale. Gjithashtu me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, po ashtu konform nenit 269 par.3 të KPRK-së, lidhur me nenin 115 të KPPK-së, propozoi që të konfiskohet substanca narkotike e llojit “Marihuanë” me peshë 0.70gr., një mulli dhe një grinder.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike::

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari E. R. : **-me dt.21.01.2022 rreth orës 22:00 min, në Rr. “Skënderbeu” -Gjakovë,** patrulla policore gjatë pikës së kontrollit kishte ndal veturën e tipit . . . me targa . . . , me shofer-dëshmitarin F. B. dhe pasagjer të pandehurin E. R. dhe dëshmitarin S. P., të njëjtit pas legjitimitetit janë kontrolluar dhe gjatë kontrollës është vërejtur se i pandehuri pa autorizim ka poseduar narkotik, substanca psikotrope ose analoge, në atë mënyrë që ditën kritike në kohën dhe vendin e lartcekur, zyrtarët policor gjatë kontrollit tek i pandehuri E. në gjepin e majtë të xhakëtës së tij është gjetur një mulli (grinder) ndërsa pas kontrollit të detajuar është gjetur sasi e substancës narkotike, ku sipas raportit të ekspertimit të dt.25.02.2022 rezultoi te jetë narkotikë i llojit Marihuanë me peshe neto 0.70 -0.0001 gram. **-me çka ka kryer veprën penale posedim i paaautorizuarit narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-ës,**

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të së cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 te KPPK-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat me lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, më parë duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike të tij.

Me rastin e matjes së dënimit ,gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 69 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit . Rrethana rënduese nuk gjeti përpos konstatimit të kryerjes së veprës penale si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh personalitetin e të akuzuarit se i njëjti është i moshës së re , pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari në shqyrtimin fillestar , sjelljen korrekte të akuzuarit në gjykim, pendimin e tij , premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale të natyrës së njëjtë apo të ngjashme , gjendjen e dobët ekonomike si dhe faktin se është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, të cilat rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënim me gjobë në shumën prej nga **300.00 (treqind) euro,** do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se ky sanksion do të ndikoj tek i akuzuari që në të ardhmen të mos kryej vepra penale, si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për konfiskimin e substancës narkotike të llojit marihuan me peshë 0.70+-0.000 gram, një mulli dhe një grinder, të sekuestruara me datën 21.01.2022, u murr komform nenit 269 par.3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej 30,00 €, është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P.nr.193/22 më datë 19.08.2022**

**Zyrtarja ligjore,
Merita Xharavina**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **15ditësh** nga dita e marrjes së tij në dorëzim ,Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet në Gjykatë.